



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2022:219983

Datë: 17.10.2023

Numri i dokumentit: 04790283

P.nr.510/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Rilind Sermaxhaj, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Eronita Llapashtica, në çështjen penale kundër të pandehurve A.K nga fshati....., Komuna e Lipjanit, E.H nga Lipjani dhe D.K nga fshati....., Komuna e Lipjanit, për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 315 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të cilët i mbrojnë avokatët Fidan Hetemi nga Lipjani dhe Elbasan Alidema dhe Donat Huruglica që të dy nga Gjilani, duke vepruar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.nr.1878/2022, të datës 24.10.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik në të cilën kanë prezantuar prokurori i shtetit Isuf Sadiku, i dëmtuari A.H, të pandehurit A.K, E.H dhe D.K, me mbrojtësit e tyre Fidan Hetemi, Elbasan Alidema dhe Donat Huruglica, me datë 06.10.2023, mori dhe shpalli ndërsa me datë 17.10.2023 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

Të pandehurit:

1. A.K, nga babai Xh dhe nëna F e lindur G, i lindur me datënë Prishtinë, ndërsa me vendbanim në fshatinKomuna e Lipjanit, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa punësuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, identifikuar me numër personal.....,
2. E.H, nga babai M dhe nëna S, e lindur Z i lindur me datë në Lipjan, ndërsa me vendbanim në fshatinKomuna e Lipjanit, rruga:....., ka të kryer shkollën e fillore, i pa martuar, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa punësuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, identifikuar me numër personal dhe
3. D.K, nga babai R dhe nëna Z e lindur D i lindur me datë, në Prishtinë ndërsa me vendbanim në fshatin....., Komuna e Lipjanit, ka të kryer shkollën e mesme, i pa

martuar, i gjendjes së mesme, i pa punësuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, identifikuar me numër personal.....,

JANË FAJTOR

Sepse më datë 17.09.2022, rreth orës 00:47 minuta, në fshatinKomuna e Gjilanit, në bashkëkryerje, me dashje dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për vete apo për tjetrin, kanë kryer vjedhje të rëndë në objektin pronë e të dëmtuarit A.H ashtu që fillimisht i thyejnë dritaret e kombit i cili ndodhej në oborrin e objektit, më pas e hapin dhe nga aty nxjerrin pajisjet për furrë të vendosura në të dhe nga këto pajisje nxjerrin kabllo dhe elektronikën, e më pas e thyejnë edhe dritaren e objektit dhe depërtojnë brenda ku marrin kablo bakri dhe kablo të rrymës të cilat i shesin në një depo mbeturinash në Lipjan në shumë prej 60 €, me ç'rast të pandehurit me veprimet e tyre, të dëmtuarit i kanë shkaktuar dëm material në vlerë prej 2.000 €.

- Me çka kanë kryer veprën penale vjedhja e rëndë nga neni 315 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata në bazë të nenit 4, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 242 dhe 364 të KPP-ës të pandehurit e lartcekur:

I GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej nga 400 € (katërqind euro) dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 1 (një) viti për secilin prej tyre veç e veç, të cilat dënime do të ekzekutohen në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse të pandehurit nuk dëshirojnë, nuk mundën ose nuk janë në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do t'iu zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim secilit prej tyre veç e veç.

Obligohen të pandehurit e lartcekur që në emër të kërkesës pasurore juridike në mënyrë solidare të dëmtuarit A.H t'ia kompensojë dëmin e shkaktuar në shumën prej 2000 € (dymijë euro) në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Obligohen të pandehurit e lartcekur që secili prej tyre veç e veç të paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej nga 50 € (pesëdhjetë euro) dhe shumën prej nga 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

ARSYETIM

1.Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjiilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 25.10.2022 ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.1878/2022, kundër të pandehurve A.K, E.H dhe D.K për shkak të veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 315 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

Me aktgjykimin e kësaj gjykate P.nr.1004/2022 të datës 25.01.2023, të pandehurit e lartcekur për veprën penale e cila u vihet në barrë janë shpallur fajtor dhe janë dënuar me dënimet përkatëse, kundër këtij vendimi është parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës e cila me aktvendimin e saj PA1.nr.425/2023 e ka anuluar vendimin e gjykatës së shkallës së parë duke i dhënë edhe udhëzimet se si duhet të veprohet në rivendosje.

Me datë 03.10.2023 pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën seancën kanë prezantuar prokurori i shtetit Isuf Sadiku, i dëmtuari A.H, të pandehurit A.K me mbrojtësin e tij me autorizim avokatin Fidan Hetemi nga Lipjani, i pandehuri E.H me mbrojtësin e tij të caktuar sipas detyrës zyrtare avokatin Elbasan Alidema nga Gjilani dhe i pandehuri D.K me mbrojtësin e tij të caktuar sipas detyrës zyrtare avokatin Donat Huruglica nga Gjilani, në këtë seancë gjykata duke vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës së shkallës së dytë fillimisht u ka caktuar mbrojtës sipas detyrës zyrtare të pandehurve E.H dhe D.K dhe atë avokatët Elbasan Alidema dhe Donat Huruglica ndërsa për të pandehurin A.K një gjë e tillë nuk ishte e nevojshme meqenëse i njëjti e kishte mbrojtësin e tij sipas autorizimit avokatin Fidan Hetemi nga Gjilani, dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit të pandehurit e lartcekur secili prej tyre veç e veç kanë deklaruar se e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohen dhe se e pranojnë fajësinë për kryerjen saj

me ç'rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurve të lartcekur.

2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata në seancën e shqyrtimit fillestar pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurve ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 242 paragrafi 1 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurve nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente përfshirë prokurorin e shtetit dhe të dëmtuarin. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se të pandehurit e kanë kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurve pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësit e tyre, të pandehurit nuk kanë qenë të detyruar ose të shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojnë fajësinë, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë provat personale dhe materiale dhe atë: raporti i hetuesit, deklaratat e të pandehurve A.K, E.H dhe D.K, deklaratat e dëshmitarit G. O dhe L.Z, deklaratat e të dëmtuarit A.H, fotografi nga vendi i ngjarjes dhe CD-ja me video incizim, po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurve gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabim faktik.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: të pandehurit A.K, E.H dhe D.K kanë kryer veprën penale vjedhje e rëndë nga neni 315 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurve duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesve si dhe përgjegjësinë penale të tyre ashtu që me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës ashtu që mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurve në të cilën përfshihet fakti se të njëjtit ka qenë plotësisht të përgjegjshëm për veprimet e tyre sepse në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kanë lënguar nga ndonjë sëmundje mendore apo ndonjë sëmundje tjetër, faktin se të njëjtit kanë paraqit një shkallë të lartë të vetëdijes dhe dëshirës për ta kryer veprën penale si dhe faktin se veprën penale e kanë kryer me dashje dhe atë direkte, po ashtu me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata pati parasysh sjelljen e mëparshme të kryesve si dhe pranimin e fajit nga ana e tyre.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata është bazuar edhe në rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës ashtu që si rrethana lehtësuese për të pandehurit mori pranimin e fajësisë për kryerjen e veprës penale në një fazë të hershme të procedurës penale, pendimin e tyre për kryerjen e veprës penale, keqardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurve për kryerjen e kësaj vepre penale, kërkim faljen e tyre ndaj të dëmtuarit përfshirë edhe atë në gjykatore, faktin se kjo ishte hera e parë që bien ndesh me ligjin si dhe premtimin e tyre që në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale ndërsa si rrethana rënduese për të pandehurit gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e të pandehurve në të cilën përfshihet planifikimi dhe përgatitja për kryerjen e veprës penale meqenëse të pandehurit fillimisht nga vendbanimet e tyre jashtë territorit të Komunës së Gjilanit, kishin identifikuar vendin e kryerjes së veprës penale, më pas kishin ardhur aty, kishin hyrë objektin prone e të dëmtuarit A.H duke i thyer dritaret e kombit i cili ndodhej në këtë objekt, të cilin më pas e hapin dhe nga aty nxjerrin pajisjet për furrë të vendosura brenda në të e më pas e thyejnë e dhe objektin dhe nga aty marrin kablllo të cilat i shesin në deponinë e mbeturinave, po ashtu si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata mori edhe këmbëngulësinë e shfaqur nga ana e të pandehurve për kryerjen e veprës penale sepse siç shihet nga përshkrimi faktik dhe provat e çështjes del se të pandehurit kanë qenë të vendosur për kryerjen e veprës penale duke ndërmarrë veprimet siç përshkruhen në dispozitiv të këtij aktgjykimi andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 i KPRK-ës gjykata të pandehurve u shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurve mund të

arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurve nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

5. Vendimi lidhur më kërkesën pasurore juridike

Gjykata duke pasur parasysh se në dispozitivin e aktit akuzues është caktuar saktë vlera e dëmit e cila nuk është kundërshtuar as nga të pandehurit vendosi që të pandehurit në emër të kërkesës pasurore juridike ti obligojë që në mënyrë solidare dhe në afat prej 15 ditësh të dëmtuarit A.H t'ia paguajnë dëmin e shkaktuar me vepër penale në shumën prej 2000 €.

6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (njëzet euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.510/2023, me datë 17.10.2023

Zyrtarja Ligjore,
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Rilind Sermaxhaj

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.